Kuvendi i komunës së Rahovecit, duke vendosur sipas kërkesës së **Fadil Ahmet Gashi, nga Rahoveci**, 08 nr. 3249 të dt. 29.11.2011, në çështjen administrative – ndërrimit të paluajtshmërisë, në bazë të nenit 4 al. 1. të Ligjit mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme, "Gazeta zyrtare e KSAK", nr. 45/81, 29/86 dhe 28/88), i cili në mungesë të ligjit material sipas Rregulloreve të 24/1999 dhe 59/2000, për ligjet në Kosovë, konsiderohet si ligj i aplikueshëm, nenit 17, 41 dhe 43 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/-040, nenit, nenit 13 dhe 84 të Ligjit për procedurën administrative nr. 02/L-28, nenit 29. pika 2. dhe nenit 58 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Kuvendi i komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vetë të mbajtur më_____ 2012, merr

A K T V E N D I M

I.- APROVOHET kërkesa e Fadil Ahmet Gashi, nga Rahoveci, dhe **LEJOHET** ndërrimi i paluajtshmërisë në formë të parcelizimit me proporcion 1:1, siç vijon:

-Fadil A. Gashi, nga Rahoveci, jep komunës së Rahovecit, ngastrat e veta nr. 1661-2, arë, në sipërfaqe prej 420 m2; 1668-0 arë në sipërfaqe prej 1069 m2; 1670-0 arë në sipërfaqe prej 1184 m2 dhe ngastrën nr. 1686-0 arë në sipërfaqe prej 632 m2, të gjitha nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 555 z.k. Xërxë, për

- ngastrën në pronësinë shtetërore nr. 1685-0 jopjellore – uji, në sipërfaqe prej 1179 m2, ngastrën nr. 1687-2 jopjellore në sipërfaqe prej 408 m2, dhe 1713-2 në sipërfaqe prej 452 m2, të tria nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 97 z.k. Xërxë; ngastrën nr. 1704-2 rrugë e pa kategorizuar e cila është jashtë përdorimit në sipërfaqe prej 544 m2, nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 102 z.k. Xërxë dhe ngastrën nr. 1766-2, jopjellore – uji në sipërfaqe prej 722 m2, nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 103 z.k. Xërxë.

Meqenëse ngastrat të përmendura kufizohen njëra me tjetrën, ndërrimi kryhet në formë të parcelizimit, në atë mënyrë që ngastra private nr. 1661-2 i bashkëngjitet ngastrës shtetërore nr. 1794; ngastra private nr. 1686 i bashkëngjitet ngastrës shtetërore nr. 1688 dhe ngastrat private nr. 1668-0 dhe 1670-0 i bashkëngjiten ngastrës shtetërore nr. 1666-2, ndërsa ngastrat në pronësi shtetërore nr. 1685-0, 1713-2 dhe ngastra nr. 1687-2 dhe 1704-2 i bashkëngjiten ngastrës privat e nr. 1687-1 ndërsa ngastra shtetërore nr. 1766-2 i bashkëngjitet ngastrës private nr. 1770/2.

II.- Zyra kadastrale komunale Rahovec, në bazë të këtij aktvendimi do ta kryej regjistrimin e paluajtshmërisë siç është cekur më afër nën I. të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Fadil A. Gashi, nga Rahoveci, me kërkesën e vetë 08 nr. 3249 të dt. 29. 11. 2011 nëpërmjet Drejtorisë për kadastër, gjeodezi dhe pronë, është drejtuar Kuvendit komunal Rahovec, që t'iu lejohet ndërrimi i paluajtshmërisë, siç është cekur më afër në dispozitiv të këtij aktvendimi.

I përmenduri në kërkesën e vetë përveç tjerash ka thekësuar se NTPP "Elkos" nga Peja, si shfrytëzues dhe posedues i paluajtshmërisë së tijë, në bazë të Projektit ekzistues, planifikon të ndërtojë Fabrikën për grumbullimin dhe përpunimin e prodhimeve të perimeve të konservuara në Xërxë. Mirëpo, meqenëse ndërmjet pronës private ekziston

prona shtetërore në formë të enklavës e cila me zbatimin e rregullimit të tokës përmes komasacionit dhe ndërtimit të HS "Radoniq" tani është jashtë përdorimit dhe nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllimi, kërkon që t,iu mundësohet ndërrimi i paluajtjshmërisë me proporcion 1:1

Kërkesa me të gjitha shkresat e lëndës është ceduar Drejtorisë për kadastër, gjeodezi dhe pronë – Sektorit për pronë që të njëjtën të përgatisë dhe të dërgojë në shqyrtim Komitetit për politikë dhe financa. Ky komitet në mbledhjen e vet të mbajtur më 17.01.2012 ka shqyrtuar kërkesën e të përmendurit me të gjitha shkresat të lëndës dhe pas shqyrtimit ka konkluduar se ky ndërrim në formë të parcelizimit është me interes të dyanshëm, duke propozuar - rekomanduar Kuvendit që në njërën nga mbledhjet e veta rregullta të njëjtën ta aprovojë si të arsyeshme.

Kjo drejtori, nëpërmjet ekspertit teknik nga lëmi i gjeodezisë, në vendin e ngjarjes ka konstatuar se ngastrat shtetërore të cilat i kërkon pala e interesuar më afër të cekura në dispozitiv të këtij aktvendimi në të dyja anët kufizohen me pronën e tijë dhe nuk shfrytëzohen për kurrfarë qëllimi, ndërsa ngastrat e tija nr. 1668-0, 1670-0 kufizohen me ngastrën shtetërore nr. 1666-2, ngastra nr. 1686-0 kufizohet me ngastrën shtetërore nr. 1688-0 dhe ngastra nr. 1661/2 kufizohet me ngastrën shtetërore nr. 1794. Pas vërtetimit të gjendjes faktike në vendin e ngjarjes, gjeometri ka hartuar skicën e terrenit dhe kopjen e planit, në të cilat është pasqyruar qartë paluajthmëria e cila kërkohet dhe ajo e cila ofrohet për ndërrim.

Kuvendi komunal Rahovec në mbledhjen e vetë të mbajtur më _____ 2012 duke shqyrtuar kërkesën dhe shkresat tjera të lëndës, ka vendosur që e njëjta të aprovohet meqenëse ekziston interesi i dyanshëm, nga se në territorin e Rrafshit të Dukagjinit, nuk ekziston asnjë Fabrikë për grumbullimin dhe përpunimin e perimeve të konservuara, dhe se me ndërtimin e këtij objekti industrial, më së shumti do të përfitojnë bujqit e kësaj ane, të cilët kryesisht merren me kultivimin e prodhimeve nga perimet.

Nga arsyet të cekura më lartë është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Ky aktvendim në procedurën administrative është përfundimtar. Kundër të njëjtit mund të zhvillohet kontesti administrativ pranë Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit.

KUVENDI I KOMUNES SE RAHOVECIT
01 nr. 169/2011
Rahovec,_____/2012

KRYESUESI I KUVENDIT,
KujtimPopaj